

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-SË,  
AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH, NË TAKIMIN NDËRKUFITAR  
PËR ÇËSHTJE TË ANTITRAFIKIMIT  
14 tetor 2011, Tirana International Hotel**

Zëvendësministre Zajmi,  
Zëvendësministër Rašić,  
Zonja Constant,  
Të nderuar të ftuar,  
Zonja dhe zotërinj,

Mirëdita!

Në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, jam shumë i gëzuar që t'ju uroj mirëseardhjen këtë mëngjes në këtë takim ndërkufitar mbi temën e trafikimit të qenieve njerëzore.

Më lejoni, së pari, të shpreh vlerësimin tim dhe të falënderoj Zëvendësministren Iva Zajmi dhe stafin e saj, Zëvendësministrin Sasha Rasiq dhe përfaqësuesen e “Terre des Hommes” në Shqipëri Sendrine Constant për angazhimin dhe punën e tyre të madhe për organizimin dhe kontributin që kanë dhënë për mbajtjen kësaj veprimtarie të rëndësishme.

E konsideroj privilegj që të kem mundësi të ndaj me ju disa mendime për këtë temë që kemi ardhur të diskutojmë këtu – trafikimi i qenieve njerëzore dhe çka është më shqetësuesja – trafikimi i fëmijëve.

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore bazohet në një qasje komplekse dhe shumëdimensionale, siç është, në perceptimin tim, edhe vetë ky fenomen.

Prezenca e OSBE-së, në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe Planin e Veprimit të vitit 2003 për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, është në mbështetje të plotë me një qasje që sjell së bashku dimensionin politik, ekonomik dhe atë njerëzor.

Lufta kundër trafikimit kërkon vullnet dhe veprime të kombinuara në të gjitha nivelet. Për këtë është me rëndësi të jashtëzakonshme vullneti politik nga të gjitha palët duke përfshirë edhe nivelet më të larta.

Ne shpresojmë se ju do ta çoni luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore – dhe sidomos trafikimin e fëmijëve – pikërisht në këto nivele të larta politike dhe operationale në institucionet dhe agjencitë tuaja përkatëse.

Natyrë e këtij krimi është e tillë që një veprim i kësaj lufte i vetëm nuk mund të çrrënjosë një herë e mirë këtë fshikullim kaq të dëmshëm të trafikimit të qenieve njerëzore.

Në të vërtetë, bashkëpunimi i fortë midis aktorëve shtetërorë dhe shoqërisë civile është i rëndësishëm për arritjen e këtij suksesi.

Kur shohim sesi shfrytëzohen dhe trafikohen fëmijët brenda dhe jashtë kufijve, mund të themi që realiteti sot është dramatik, madje edhe më shumë, është tragjik.

I njohim të gjithë shembujt e shumtë të fëmijëve që detyrohen të lypin në rajon dhe më tej.

Për më tepër, kjo situatë i bën fëmijët më të ekspozuar ndaj shfrytëzimit seksual.

Fatkeqësisht, fëmijët lypës janë një pamje e zakonshme, që ne që banojmë në Tiranë, e shohim çdo ditë.

Një shfrytëzim i tillë, shpesh prej familjeve të tyre, e bën identifikimin e tyre si "viktima të trafikimit" veçanërisht të vështirë dhe e bën mbrojtjen e tyre thuajse të pamundur.

Kështu, e vendosur përkundrejt këtij sfondi tematik, synimi i aktivitetit të sotëm është të diskutojë mënyra për rritjen e bashkëpunimit ndërkuftar lidhur me identifikimin, referimin dhe ndihmesën për fëmijët që janë viktima të trafikimit si edhe fëmijët që janë viktima potenciale të trafikimit.

Unë besoj që një studim i kohëve të fundit nga “Terres des Hommes” dhe “Save the Children Albania” vërejtji se fëmijë dhe familjet e tyre nga Republika e Shqipërisë, migrojnë në veri-lindje të kufirit kryesisht për të lypur ose për të mbledhur mbeturina.

Ata hasin situata sfiduese socialo-ekonomike që shërbejnë vetëm për të bashkuar dhe më tej marxhinalizimin, përjashtimin dhe privimin e tyre nga mbrojtja e duhur për fëmijët, dhe nga qasja e duhur sociale ndaj shërbimeve sociale.

Ata fëmijë janë gjithashtu të ekspozuar ndaj rrezikut të shfrytëzimit nga krimi i organizuar për qëllime seksuale dhe punë të detyruar.

Raporti bën thirrje për një koordinim më të mirë ndërkuftar, në mënyrë që të sigurojë identifikim proaktiv, ashtu si edhe më të mirën për fëmijën.

Dua të theksoj që identifikimi dhe mbrojtja sociale e fëmijëve të trafikuar është një përgjegjësi e përbashkët e vendeve të origjinës dhe ato të destinacionit.

Fatkeqësisht, prirja e fëmijëve të pashoqëruar për t'u larguar përtej kufijve të Republikës së Shqipërisë është e vazhdueshme.

Sigurisht, nuk është e lehtë që të përcaktohet sesa prej këtyre fëmijëve janë trafikuar.

Sidoqoftë, diçka është e sigurt – ata janë tejet të cenueshëm nga abuzimi dhe shfrytëzimi.

Prandaj, është e rëndësishme që autoritetet përkatëse në të dyja anët e kufirit të krijojnë sisteme efikase.

Është e rëndësishme që ata të ndalin kthimin e fëmijëve përpara krijimit të një mjedisi të qëndrueshëm dhe të sigurt.

Sigurisht, që të gjithë ne që jemi të pranishëm këtu sot, ashtu si edhe ata përkrah të cilëve ne punojmë në këtë fushë, e kemi detyrë, angazhim, dhe përgjegjësi mbrojtjen e atyre fëmijëve.

Miq të nderuar,  
Zonja dhe zotërinj,

Shpresoj sinqerisht që draftprotokolli i bashkëpunimit që do të diskutohet këtu sot do të shërbejë si një themel i fortë për bashkëpunim të mëtejshëm duke pasur si synim përfundimtar parandalimin e trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre.

Me lejoni t'ju them, gjithashtu, që Prezenca e OSBE-së do të vazhdojë të mbështesë nismat që synojnë zhdukjen e shfrytëzimit të fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të tyre.

Ju faleminderit dhe ju uroj një aktivitet të suksesshëm!

**Fund**